



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 63, Datë 27.1.2016

PËR

**RIORGANIZIMIN E OPERATORËVE QË OFROJNË SHËRBIMIN E
FURNIZIMIT ME UJË TE PIJSHËM, GRUMBULLIMIN, LARGIMIN
DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100, e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 213 e vijues të ligjit nr. 9901, 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, të shkronjës “a” dhe “b”, të pikës I/3 të nenit 10, të pikës 3 të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

KREU I

**RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM,
GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

1. Riorganizimin e të gjithë shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

2. Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, organizohen si shoqëri aksionere, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”
3. Bashkive iu transferohen aksionet e shoqërive Sh.a Ujësjetllës Kanalizime aktuale, në pronësi të ish njësive të qeverisjes vendore të shkrira, sipas ndarjes së re administrative territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjetllës kanalizimeve, bashkia brenda afatit 31 Dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Sh.a Ujësjetllës Kanalizimeve në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrative territoriale.
5. Bashkitë dhe Sh.a Ujësjetllës Kanalizime, janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë/detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjetllës kanalizimeve dhe ish njësive të qeverisjes vendore me Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.
6. Në rastet kur në dy ose me shumë bashki ekziston vullneti i përbashkët për krijimin e një Sh.a Ujësjetllës Kanalizime të përbashkët, mbështetur në nevojat për këtë bashkim, si dhe në studimin përkatës, ato do të mbështeten me investime nga qeverisja qendrore.
7. Në rastet kur një Sh.a Ujësjetllës Kanalizime ekzistuese mbulon me shërbim më shumë se një bashki, apo në rastin e parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi, organet themeluese të shoqërisë përbëhen nga përfaqësuesit e bashkive përkatëse, pesha e vendimarrjes të të cilëve, është në raport të drejtë me përqindjen e aksioneve që disponon secila bashki. Këshillat bashkiake respektive, bëjnë miratimin e përqindjeve takuese të aksioneve sipas pikës 3 të këtij vendimi, si dhe organet e shoqërisë bëjnë rregjistrimin e aksioneve sipas legjislacionit në fuqi.
8. Sh.a Ujësjetllës Kanalizime, kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe Prefektit të Qarkut, të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve dhe afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së Informacionit, miratohen me

udhëzime të Ministrit të linjës. Gjithashtu shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar pjesën e vet të të dhënave për t'u hedhur në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

9. Ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, në planifikimin e fondeve për investime nga buxheti i shtetit dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare udhëhiqet nga dokumentat strategjik sektorial të miratuar, si dhe nga performanca e Sh.a Ujësjiellës Kanalizimeve.
10. Staf i menaxherial dhe operacional i Sh.a Ujësjiellës Kanalizimeve, i nënshtrohet procesit të trajnimit dhe çertifikimit sipas programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

KREU II

DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Sh.a Ujësjiellës Kanalizime organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Të gjithë bashkitë dhe shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjiellës kanalizimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", bëjnë zgjerimin dhe zvogëlimin e kapitalit sipas rastit duke shtuar ose hequr kapitalet e sistemeve publike të ujësjiellës kanalizimeve që i bashkohen ose që i hiqen.
3. Të gjithë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime, brenda 3 (tre) muajve nga riorganizimi, aplikojnë për pajisjen me liçencë për kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe për rishikim të tarifave pranë ERRU-së.
4. VKM nr.660, datë 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjiellësve dhe kanalizimeve njësvite të qeverisjes vendore", VKM nr.677, datë 3.10.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", VKM nr.678, datë 3.10.2007 "Për një shtesë në vendimin nr.271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore", shfuqizohen.
5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Enti Rregullator i Ujit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve, Agjensia e Zbatimit të Reformës Territoriale , njësitë e qeverisjes

vendore, Sh.a Ujësjetës Kanalizime/Sh.a Ujësjetës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA